

URDHËR
Nr. 386, datë 26.6.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në zbatim të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2, të nenit 28 e në vijim të Kodit të Procedurës Administrative si dhe pikës 2, të kreut V, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës, jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në largësi mbi 100 km, të lëshohen përkatësisht nga titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës të zbatojnë kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.

3. Ngarkohen titullarët e institucioneve në varësi të Ministrisë së Kulturës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti